



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 580/11 prot.

Datë 19.03.2026

V E N D I M
Nr. 409/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.351/2026, datë 05.03.2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-74201-01-20-2026, me objekt “Blerje materiale pastrimi, detergjent” me fond limit 5.083.320 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” ShPK me NIPT K91624505A, Adresa: Fshati Ahemtaq, pranë firmës Ital Kon, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vlorë.
Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga “Osman Haxhiu” Vlorë.
- Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “ANBIM SHPK” ShPK, me Nipt L81618008J, Adresa: Autostrada TR-DR Km1 Z. Kadastrale 2679 Nr. pasurie 40/55, Tiranë.

Operatori ekonomik “BESIM KAMBERI P.F, me Nipt L42103023G, Adresa: Rr. e Qelqit , Z. Kadastrale Nr 3866 Nr Pasurie 310/20 – Kashar, Tiranë..
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Me Vendimin Nr.351/2026, datë 05.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik EURO MEGA 2010 ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”Mallra, me Nr. REF-74201-01-20-2026, me objekt “Blerje materiale pastrimi, detergjent” me fond limit 5.083.320 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.*
2. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertat duke skualifikuar operatorët ekonomikë ANBIM ShPK dhe BESIM KAMBERI P.F, sipas vendimmarrjes së KSHA-së.*
3. *Autoriteti Kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP-në mbi veprimet e ndërmarra në përputhje me Vendimin e KSHA-se dhe konstatimet e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik EURO MEGA 2010 ShPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

I.2. Me shkresën ardhur me shërbim postar me Nr. 1147/13 Prot., datë 12.03.2026 protokolluar me tonën me nr. 580/8, datë 17.03.2026, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar Vendimin e KPP-së me Nr. 351/2026, datë 05.03.2026 për procedurën e prokurimit objekt gjykimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën ardhur me shërbim postar me Nr. 1147/13 Prot., datë 12.03.2026 protokolluar me tonën me nr. 580/8, datë 17.03.2026, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar Vendimin e KPP-së me Nr. 351/2026, datë 05.03.2026 për procedurën e prokurimit objekt gjykimi.

II.2. Referuar shkresës sipërcituar si edhe nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor më datë 10.03.2026 ka kryer rivlerësim të ofertave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në zbatim të vendimit KSHA-së dhe konstatimeve të Vendimit të KPP-së.

II.3. Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë. ka zbatuar vendimin Nr. 351/2026, datë 05.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-74201-01-20-2026, me objekt “Blerje materiale pastrimi, detergjent” me fond limit 5.083.320 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-74201-01-20-2026, me objekt “Blerje materiale pastrimi, detergjent” me fond limit 5.083.320 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Gjergj Mersini

Anëtar

Anila Malaj

Nënkryetar

Fiorent Zguro

